



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 52, datë 27.02.2025

PËR

REFUZIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN:
“KOMPLEKS BANIMI DHE HOTELERI ME STRUKTURA 1, 2, 3 KATE MBI TOKË
DHE 1 KAT NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË SARANDË

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Nenit 10/2 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” e ndryshuar, me propozim të subjekti zhvilluesi shoqërisë “S&D” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Refuzimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Kompleks banimi dhe hoteleri me struktura 1, 2, 3 kate mbitokë dhe 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Sarandë, me subjekt zhvillues shoqërinë “S&D Invest” sh.p.K
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.
4. Kundër këtij Vendimi, lejohet ankim nga pala e interesuar, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në Ligj Nr. 44/2015 “Kodin e Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 02/05/2025